



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:178753

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05668847

KA.nr.685/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “KRU Prishtina” ShA me seli në rrugën Hazir Shala nr. 4 në Prishtinë, kundër të paditurit Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 03.04.2024 në të cilën morën pjesë të dy palët, më 2 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “KRU Prishtina” ShA me seli në Prishtinë kundër të paditurit Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.113/2021 të datës 13.07.2021 të së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 12.08.2021 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit nr.113/2021 të datës 13.07.2021 të së paditurit Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit me seli në Prishtinë.
2. Paditësi në padi por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se vendimi goditur është si jomeritor për shkak të mos zbatimit të drejtës të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të gjendjes faktike. Ka theksuar se i Padituri nuk ka marrë për bazë vendimin e Paditësit i cili ka qenë në pajtim me nenin 35 pika 1 të rregullores nr.02/2016 për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë. Më tutje ka shtuar se vendimi i goditur është konfuz dhe i paqartë për arsye se nuk është sqaruar barazimi i gjendjes me matës me gjendjen e faturimit. Përveç kësaj, ai ka shtuar se përderisa konsumatori nuk ka paraqit asnjëherë kërkesë për kalibrim të ujëmatësit me nr. 53069338, ai (Paditësi) asnjëherë nuk e ka bërë kalibrimin e tij që nga data e montimit.

3. I Padituri me përgjigjen në padi, por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Gjatë seancës ka deklaruar se vendimi i atakuar drejtë ka zbatuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar gjendjen faktike, kur duke zbatuar rregulloren për standardet minimale të shërbimit të ujit në Kosovë dhe kur ka urdhëruar paditësen që borxhin apo faturimin prej 3,616.00 euro ta shlyej për arsye se kjo ka ardhur si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve ligjore nga ana e ofruesit të shërbimeve. Sipas tij, Paditësi ka përdorur standarde të dyfishta të trajtimit të vendimeve të shkallës së dytë apo të ARRU-së, sepse rastet precedentë të të njëjtit vendbanim apo zonë shërbimi sipas dëshmimeve që janë në shkresat e lëndës të disa ankuesve të tjerë apo të konsumatorëve të tjerë paditësi i ka zbatuar vendimet duke i shlyer faturimet enorme të cilat dëshmojnë qartë se në këtë zonë shërbimi faturimi nuk ka qenë sipas leximit të ujëmatësve por paushall ose me hamendsim dhe kur paditësi e ka mbuluar zonën e shërbimit me lexues të ri ka ndodhur këto faturime dhe ka ardhur të shpërfaqja e neglizhencës të përmbushjes së detyrave ligjore të ofruesit të shërbimeve. Në këtë drejtim ka shtuar se faturimi paushall është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe m Ligjin për Ofrimin e Shërbimeve të Ujit e po ashtu rregulloren 08/2018 për ndryshimin e rregullores 02/2016 për standardet minimale të ujit në Kosovë, e cila ka përcaktua qartë se faturimi i konsumatorëve duhet të bëhet vetëm sipas leximit të ujëmatësit.

## II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

1. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e provave. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: procesverbali për kontrollim dhe inspektim me nr. prot. 41/14-SB i datës 29.10.2020 i lëshuar nga Paditësi; procesverbali për shqyrtimin e ankesës të konsumatorit S.I.; kartela e matësit për periudhën kohore 01.01.2020-01.10.2020 në emër të S.I.; kontrata e shërbimeve të ujit e lidhur mes Paditësit dhe S.I. me datën 28.10.2020; vendimi i datës 30.11.2020 për refuzimin e kërkesës së konsumatorit lidhur me kontestimin e faturimit për S.I.; vendimi i datës 10.03.2021 për refuzimin e ankesës së konsumatorit në emër të S.I.; janë shikuar fotografitë e ujëmatësit me nr. 53069338 për gjendjen faktike të datës 28.08.2020, 14.12.2020, 25.01.2021, 19.03.2021 dhe 18.05.2021; lista e procesverbaleve për muajt gusht 2020, dhjetor 2020, janar 2021, mars 2021 dhe maj 2021; kartela financiare e

konsumatorit S.I. për periudhën kohore 01.01.2013 – 11.08.2021; vendimi nr. 113/21 dhe nr.prot 243/02 të datës 15.07.2021 i të paditurit; formulari i ankesës në emër të konsumatorit S.I. me nr. ref. 233898 i datës 28.10.2020 së bashku me ankesën e bashkëngjiturK kartela e ujëmatësit me nr. 0032540 në emër të konsumatorit S.I. për periudhën kohore 2013-2014, si dhe komplet shkresat e lëndës të procedurës administrative të dorëzuara nga i Padituri në përgjigjen në padi.

2. Në bazë këtyre provave gjykata konstaton se Paditësi i kishte faturuar konsumatorit S.I. nga Hajvalia (këtu e tutje Konsumatori) shpenzimin e sasisë prej 7786m<sup>3</sup> të ujit për muajin gusht 2020, gjegjësisht shumën prej 3,616.90€. Ndaj kësaj fature Konsumatori kishte ushtruar ankesë më 28.10.2020
3. Më 29.10.2020 Paditësi kishte bërë një inspektimin te Konsumatori dhe kishte konstatuar se ujëmatësi nr. 53069338 (këtu e tutje Ujëmatësi), i cili ka qenë i vendosur te Konsumatori, e ka gjendjen e shpenzimeve prej 9204m<sup>3</sup> ujë të shpenzuar. Gjithashtu ka konstatuar se Ujëmatësi ka bllobë. Këto fakte gjykata i konstatoi përmes procesverbalit me numër serik 01433 të datës 29.10.2020.
4. Më 01.12.2020 Departamenti i Shërbimeve për Konsumator i Paditësit kishte nxjerrë vendim nr. 233898/2020 me të cilin e kishte refuzuar kërkesën (ankesën) e Konsumatorit. Pas disa ankesave dhe kthimeve në rivendosje nga i Padituri, Paditësi përfundimisht më 23.03.2021 e ka nxjerr vendimin nr. 233898/2020 me të cilën e ka refuzuar ankesën e Konsumatorit për muajin gusht 2020.
5. Në një datë të pacaktuar, Konsumatori ka paraqitur ankesë te i Paditurit kundër vendimit nr. 233898/2020 të datës 23.03.2021 për refuzimin e ankesës. I Padituri më 13.07.2021 kishte nxjerr vendimin e goditur, gjegjësisht vendimin nr. 113/21, me të cilin e kishte aprovuar ankesën e Konsumatorit, e kishte anuluar vendimin e Paditësit nr. 233898/2020 të datës 23.03.2021, e kishte obliguar Paditësin që ta anuloj faturën e tij për muajin gusht 2020 në vlerë prej 3,616.90€ dhe si faturim ta merr faturimin e datës 30.09.2020.
6. Gjykata gjithashtu konstaton se Paditësi dhe Konsumatori kishin marrëdhënie kontraktuale për shërbimet e ujit, në bazë të kontratës së datës 28.10.2020.
7. Gjykata gjithashtu ka konstatuar se Paditësi kishte filluar një procedurë disiplinore ndaj disa punëtorëve të tij për shkak të mos leximit të ujëmatësve, të cilët i kishte gjetur përgjegjës dhe u kishte shqiptuar masa disiplinore.

8. Përveç kësaj, gjykata vëren se Padiësi kishte pasur raste tjera të ngjashme në zonën e faturimit (Hajvali), në të cilat kishte lëshuara fatura në shuma tre shifrore, të cila pas një kohe i kishte anuluar.
9. Gjithashtu, gjykata konstaton se Padiësi që nga data 31.12.2013 deri 31.07.2021 vetëm për një muaj kishte pasur shpenzime të ujit që tejkalojnë shumën prej 20€, ndërsa në të gjithë muajt tjerë shpenzimet tjera të asaj periudhe kohore shpenzimet e ujit kanë qenë nën 20€.
10. Për më tepër, gjykata erdhi në përfundim se ujëmatësi i Konsumatorit nuk ishte lexuar për një kohë të gjatë, gjegjësisht për periudhën kohore prej më shumë se dy viteve, ndërsa edhe për këtë periudhë Konsumatori ka pranuar fatura nga Padiësi dhe ka bërë pagesa në favor të Padiësit për shpenzimet e ujit. Deri te ky përfundim gjykata erdhi duke i marrë parasysh faktin se Padiës ndaj lexuesit të ujëmatësit kishte shqiptuar masë disiplinore për mos lexim të ujëmatësve. Ky fakt rrjedh edhe nga konstatimet e Padiësit në vendimin nr. 233898/2020 të datës 23.03.2021, në të cilin e pranon se ujëmatësi i Konsumatorit nuk ishte lexuar.
11. Gjykata gjithashtu gjeti se, edhe pse Padiësi i kishte faturuar Konsumatorit shpenzimet e ujit për muajt e viteve të mëparshme para faturës së muajit gusht 2020, megjithatë me rastin e faturimit për muajin gusht 2020 nuk i kishte zbritur kubikët e ujit të shpenzuar dhe pagesat për faturat e më hershme të lëshuara pa e bërë leximin fare të Ujëmatësit. Pra, Konsumatorit i ishte faturuar dy herë shpenzimi e njëjta të ujit: sipas të dhënave paushalle pa e lexuar fare Ujëmatësin dhe sipas leximit për muajin gusht të vitit 2020.
12. Përfundimisht, gjykata konstaton se Konsumatori ujëmatësin e ka të instaluar që nga vitit 2013 dhe që nga ajo kohë nuk i nënshtruar asnjë verifikimi të matësve ligjor. Këto fakte gjykata i vërtetoi nga vet deklaratimet e Padiësit, të bëra gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, të cilat nuk ishin kontestuar nga i Padituri.
13. Nga provat tjera në shkresat e lëndës vërtetohen edhe fakte tjera, të cilat nuk janë relevante për zgjidhjen e çështjes, rrjedhimisht gjykata nuk i elaboroi në këtë aktgjykim.

### III. Vlerësimi meritor i rastit

14. Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të ndërgjyqësve, provave të administruara dhe të analizuara në kuptim të nenit 8 të LPK-së, si dhe analizimit të dispozitave juridike relevante gjeti se kërkesëpadia e është e pabazuar.

15. Çështja e matjes së shpenzimeve rregullohet me disa akte juridike, mes tjerash Ligjit 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, i cili në nenin 25 para. 1 ka paraparë se *“Faturimi i energjisë, ngrohjes dhe ujit llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njëhisorin e kalibruar të konsumatorit”*. Siç vërehet, ky ligj urdhëron që faturimi për shpenzimet e ujit të llogaritet vetëm në bazë të shpenzimit real të lexuar nga njëtori i kalibruar.
16. Sipas nenit 6 para. 1 nënpara. 4 të Rregullores 03/2016 për Kartën e Konsumatorit të Shërbimeve të Ujit (e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është bërë leximi i ujëmatësit të Konsumatorit) *“Konsumatori ka të drejtë që: (...) Të ketë një faturim të drejtë, të ligjshëm dhe transparent për shërbimet e ofruara, bazuar në rregulloren përkatëse të aprovuar nga Autoriteti”*.
17. Gjithashtu, sipas nenit 32 para. 4 të Rregullores 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, e ndryshuar me Rregulloren 08/2018 (e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është bërë leximi i ujëmatësit të Konsumatorit) *“Leximi i ujëmatësit nga Ofruesi i shërbimeve duhet të bëhet në intervale të rregullta, në ditët kalendarike të përafërta të ciklit lexues, jo më shpesh se një (1) herë në muaj dhe jo më rrallë se çdo tre (3) muaj”*. Siç vërehet, ARrU në këtë rregullore e ka përcaktuar obligimin për ofruesin e shërbimeve të ujit që në intervale të caktuara kohore të bëjë leximin e ujëmatësve, duke përcaktuar se leximi duhet të bëhet më së rralli çdo tre muaj. Kjo rregullore gjithashtu në nenin 34 ka paraparë se *“Përpos në rastet kur është përcaktuar ndryshëm me këtë Rregullore, ofruesi i shërbimeve duhet të i faturoj konsumatorët në bazë të konsumit të lexuar në ujëmatës. Ofruesi i shërbimeve duhet të i dërgojë secilit Konsumator një faturë për shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura, për çdo muaj, më së largu deri në datën njëzet (20) të muajit aktual, për shërbimet e ofruara në muajin paraprak. Kjo rezulton me dymbëdhjetë (12) fatura në vjet”*, ndërsa në nenin 35 para. 1 ka përcaktuar se *“Faturimi bëhet në bazë të konsumit të lexuar në ujëmatës”*.
18. Siç vërehet, dispozitat juridike të cituara më lartë, kanë përcaktuar qartë se në çfarë intervale kohore duhet të lexohet ujëmatësi. Meqenëse Paditësi kishte dështuar që ta lexoj ujëmatësin e Konsumatorit për një periudhë kohore dukshëm më të gjatë se tre muaj, atëherë ai i ka shkelë këto dispozita juridike, rrjedhimisht leximi i orës për muajin gusht të vitit 2020 ishte në kundërshtim me dispozitat e cekura më lartë. Për pasoj, edhe faturimi i gjithë shpenzimeve të muajve të mëhershëm, për të cilat Konsumatori më parë kishte

- pranuar fatura dhe kishte kryer pagesa, ishte në kundërshtim me kërkesat juridike të rregulloreve të cekura më lartë.
19. Përveç kësaj, leximi i ujëmatësve ndërlidhet edhe me saktësinë e matësve të vet ujëmatësit. Në këtë drejtim, Ligji 06/L-037 për Metrologji në nenin 22 para. 2 ka përcaktuar se *“Subjektet juridike të cilët shesin energji termike, energji elektrike, ujë apo gaz dhe të gjithë personat fizik apo juridik që posedojnë mjete matëse ligjore, janë të detyruar të përkujdesen për verifikim të rregullt të mjeteve matëse të energjisë termike, matësit e gazit, matësit e ujit dhe matësit e energjisë elektrike”*, ndërsa në para. 3 ka rregulluar se *“Me akt nënligjor përcaktohen mënyrat dhe afatet e verifikimit të rregullt të mjeteve matëse”*.
20. Njëjtë edhe neni 33 para. 1 i Rregullores 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, e ndryshuar me Rregulloren 08/2018 (e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është bërë leximi i ujëmatësit të Konsumatorit) ka përcaktuar se *“Ofruesi i shërbimeve në intervale të rregullta duhet të inspektojë dhe verifikojë saktësinë e ujëmatësve dhe të bëjë kalibrimin e tyre sipas standardeve dhe normave të aplikueshme me Ligjin për Metrologjinë dhe akteve nënligjore të cilat nxirren për këtë qëllim”*.
21. Në këtë drejtim, Udhëzimi Administrativ nr. 02/2015 për Periudhën Verifikuese të Mjeteve Matëse Ligjore, Mënyra e Zbatimit si dhe Periudhat Ri-Kalibruese për Etalonët të cilët Përdoren për Verifikimin e Mjeteve Matëse Ligjore (i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është bërë leximi i ujëmatësit të Konsumatorit), në nenin 2 para. 1 nënpara. 5 pika 2 (1.5.2) ka urdhëruar se *“Periudha kohore për verifikimin e rregullt të mjeteve matëse ligjore të cilat përdoren në këmbime tregtare tek të cilat çmimi i mallit të shitur përkatësisht shërbimit të kryer përcaktohet në bazë të matjes, e që shërbejnë për përcaktimin e: (...) Vëllimit të lëngjeve rrjedhëse dhe gazrave: (...) 1.5.2. ujëmatësit për ujë të ftohët..... 5 vite”*
22. Sipas dispozitave të cituara më lartë rrjedh se, ofruesit e shërbimeve të ujit e kanë për obligim që faturimin ta bëjnë në bazë të leximit të ujëmatësve, të cilët e kanë të verifikuar saktësinë e matjes çdo 5 vite, pra të bëjnë verifikimin e detyrueshëm periodik (shih nenin 3 para. 1 nënpara. 13 dhe 14 i Ligjit 06/L-037 për Metrologji).
23. Pasojat juridike të mos verifikimit është paraparë në nenin 27 para. 1 nënpara. 1 të 1. të Ligjit 06/L-037 për Metrologji, sipas të cilit *“Vlefshmëria e verifikimit të mjeteve matëse ligjore ndërpritet nëse: 1.1. ka skaduar validiteti i verifikimit”*. Pra, nëse ka kaluar

periudha për verifikimin e detyrueshëm, atëherë vlefshmëria e verifikimit të matësit ligjore, në rastin konkret ujëmatësit, ndërpritet.

24. Prandaj, për këtë gjykatë vlefshmëria e saktësisë së Ujëmatësit ishte ndërprerë në momentin e leximit në gusht të vitit 2020, meqenëse ai që nga vitit 2013 kusht ishte montuar nuk ishte verifikuar asnjëherë nga Paditësi. Siç rrjedh nga neni 3 para. 1 nënpara. 14 dhe 15 lidhur me nenin 15 para. 1 dhe 24 të i Ligjit 06/L-037 për Metrologji, verifikimi paraqet proces të detyrueshëm për ofruesin e shërbimeve, ndërsa nuk varet nga kërkesa për verifikim e konsumatorit. Kur konsumatori kërkon që të bëhet verifikimi i matësit ligjore (ujëmatësit), atëherë kemi të bëjmë me verifikimin e jashtëzakonshëm të mjeteve matëse, siç përcakton nenit 26 para. 2 nënpara. 4 i Ligjit 06/L-037 për Metrologji). Në këtë drejtim, edhe vet Rregullorja 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, e ndryshuar me Rregulloren 08/2018 (e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është bërë leximi i ujëmatësit të Konsumatorit) në nenin 33 para. 3 dhe 6 ka përcaktuar situatën kur verifikimi bëhet në bazë të kërkesës së konsumatorit, që paraqet procedurë të ndarë nga ajo e nenit 33 para. 1 të rregullores në fjalë, i cili e rregullon verifikimit e detyrueshëm me vet iniciativë të ofruesit të shërbimeve.
25. Prandaj, duke e marrë parasysh faktin se Paditësi kishte dështuar që ta bëjë leximin e Ujëmatësit sipas kërkesave ligjore dhe rregulloreve të cekura më lartë, si dhe për Ujëmatësin kishte kaluar koha e verifikimit të tij, atëherë gjykata vjen në përfundim se leximi i Ujëmatësit ka qenë juridikisht jo i rregullt dhe juridikisht jo i sakët. Për këto arsye, për këtë gjykatë vlerësimet juridike të së Paditurit të paraqitura në vendimin e goditur lidhur me çështjen administrative konkrete janë juridikisht të drejta, rrjedhimisht ai me të drejtë e ka anuluar vendimin nr. 233898/2020 të datës 23.03.2021 dhe e ka detyruar Paditësin që ta anuloj faturën për Konsumatorin për muajin gusht të vitit 2020 në lartësi prej 3,616.90€.
26. Në anën tjetër, gjykata gjen se procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk kishte ngritur asnjë pretendim i kësaj natyre gjatë procedurës së konfliktit administrativ.
27. Gjithashtu, gjykata vëren se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, si dhe për të gjitha pretendimet e Paditësit, që i ka paraqitur gjatë gjithë procedurës administrative. Për më tepër, gjykata konstaton se i Padituri e ka

konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim.

28. Për arsyet e cekura më lartë gjykata përfundimisht vlerëson se vendimi i goditur është nxjerrë duke i respektuar dispozitat e procedurës administrative, organi administrativ e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejtë dispozitat materiale administrative, si dhe i Padituri ka qenë organ kompetent për nxjerrjen e vendimit të tillë, rrjedhimisht nuk ka asnjë arsye ligjore që ai të anulohet, për pasojë e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e Paditësit.
29. Për arsyet e cekura më lartë, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës  
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative  
KA.nr.685/2022

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.